



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.156

10 tetor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9995 datë 22.9.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” 7675
Ligj nr.9996 datë 22.9.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” 7676
Ligj nr.9997 datë 22.9.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar 7676
Ligj nr.9998 datë 25.9.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Panhelenike të Eksportuesve për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë” 7677
Ligj nr.9999 datë 25.9.2008	Për disa ndryshime në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.. 7678
Ligj nr.10 000 datë 29.9.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për shmangien e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal” 7680
Vendim i Kuvendit nr.217, datë 6.10.2008	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri 7692
Vendim i Kuvendit nr.218, datë 6.10.2008	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri 7693

Vendim i KM nr.726, datë 28.5.2008	Për transferimin në pronësi, nga Ministria e Brendshme bashkisë Korçë, të objektit “Ish-reparti 741” dhe për një ndryshim në vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”	7693
Vendim i KM nr.818, datë 11.6.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike, në Vlorë, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	7695
Vendim i KM nr.1310, datë 6.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.1294, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007, për çështjen “Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë””	7695
Vendim i KM nr.1311, datë 6.10.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1293, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 13.11.2007, për çështjen “Driza kundër Shqipërisë””	7696
Vendim i KM nr.1315, datë 1.10.2008	Për përcaktimin e pagave dhe të shtesave mbi pagë të punonjësve shqiptarë për kohën, që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, pranë Qendrës SECI	7696
Vendim i GJK nr.22, datë 7.10.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.729, datë 28.5.2008 “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Kashar” si antikushtetues.	7697
Vendim i KNSH nr.28, datë 25.9.2008	Për miratimin e udhëzimit “Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit”	7700
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasës Elsa Muharrem Abazaj	7703
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Genc Sulejman Doku	7703
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Pëllumb Sulko ...	7703

LIGJ
Nr.9995, datë 22.9.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9663, DATË 18.12.2006 “PËR KONCESIONET”

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Ky ligj nuk zbatohet për projektet, që janë pjesë përbërëse dhe të pandashme të një projekti, për të cilin, me ligj të veçantë, autorizohet Këshilli i Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 21 pika 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlerë investimi mbi 20 milionë euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlerë nën 20 milionë euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.”.

Neni 3

Në nenin 22 pika 1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) për shkak të një shkeljeje serioze nga koncesionari kërkohet nga institucionet financiare, në bazë të së drejtës për të ndërhyrë, zëvendësimi i koncesionarit.”.

Neni 4

Në nenin 27 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “b” shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në rast se afati është mbi 35 vjet, kontrata hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi.”.

2. Pas shkronjës “o” shtohet shkronja “p” me këtë përmbajtje:

“p) të drejtën e ndërhyrjes së financuesve.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5907, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9996, datë 22.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9693, DATË 19.3.2007 “PËR FONDIN KULLOSOR”

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

1. Subjektet, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fondin kullosor, sipas nenit 17 pika 3 të këtij ligji, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik, i cili organizohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor ose, për kullotat komunale, nga njësia e qeverisjes vendore. Me subjektin fitues lidhet kontrata, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet, që duhen zbatuar gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë.

2. Kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet, për pjesëmarrjen në konkurrimin publik, miratohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 2

Në nenin 34 pika 3, fjalët “pa leje” zëvendësohen me fjalët “pa kontratë”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5908, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

**LIGJ
Nr.9997, datë 22.9.2008**

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 46, në fund të shkronjës “c” fjalët “dhe vendos masat administrative për mospërmbyshjen e tyre, sipas nenit 46/1” shfuqizohen.

Neni 2

Neni 46/1 shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5909, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9998, datë 25.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË PANHELENIKE TË EKSPORTUESVE PËR KONSOLIDIMIN E BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Panhelenike të Eksportuesve për konsolidimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5910, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRISË PANHELENIKE TË EKSPORTUESVE NË LIDHJE ME KONSOLIDIMIN E
BORXHIT TË JASHTËM TË SHQIPËRISË**

Marrëveshje e datës ____ 2008, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

(këtu i quajtur “Këshilli”), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Shoqëria panhelenike e Eksportuesve (SHPE)

Neni 1

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve, për shumat e papaguara të faturave që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara ndërmjet ish-ndërmarrjeve shtetërore të Tregtisë së Jashtme të Shqipërisë dhe kompanive greke (“Brothers Hasiotis” dhe “Dimitrios Ant.Liakos”) që kanë mbetur të papaguara.

Shuma e borxheve është si më poshtë:

Brother Hasiotis	USD 148,396.00
Dimitrios Ant.Liakos	USD 47,000.00

Neni 2

Këshilli merr përsipër t’i paguajë SHPE-së sa më parë të jetë e mundur, por jo më vonë se 31.3.2008, shumën prej 195,369.00 USD.

Neni 3

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën emarrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit të dy palët njoftojnë njëra-tjetrën zyrtarisht përfundimin e procedurave të parashikuara nga rregulloret përkatëse.

Bërë në Tiranë,2008, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.9999, datë 25.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9047, DATË 10.7.2003 “PËR SHËRBIMIN USHTARAK NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 “Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 pika 2, fjalja e dytë shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 12, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) shtetasi kryefamiljar, i martuar dhe me një apo më shumë fëmijë të mitur.”.

Neni 3

Në nenin 14, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) shtetasi kryefamiljar, i martuar, i cili, gjatë kohës së shërbimit ushtarak, bëhet me një apo më shumë fëmijë.”.

Neni 4

Neni 19 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 20, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shtetasi që, për arsye ndërgjegjeje, nuk pranon të kryejë shërbimin me armë në Forcat e Armatosura dhe kërkon të kryejë, në vend të tij, shërbim alternativ, duhet të paraqesë një kërkesë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, në qendrën e rekrutim-mobilizimit, përpara se të plotësojë moshën ligjore të thirrjes për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ose në komandën e njësisë (repartit ushtarak), kur është duke kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak.”.

Neni 6

Në nenin 27, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Qendra e rekrutim-mobilizimit përgjigjet për zbatimin e programit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, sigurimin e personelit të nevojshëm për shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv, rezervist dhe të personelit profesionist (me pagesë), për plotësimin e njësive e të reparteve të Forcave të Armatosura.”.

Neni 7

Në nenin 42, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Ky nen do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2009.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5911, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.10 000, datë 29.9.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për shmangien e tatimit të dyfishtë mbi të ardhurat dhe kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5912, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS
PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË
ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN DHE PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjës dhe Hercegovinës,

me dëshirën për të lidhur një Marrëveshje për mënjanimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Personat e përfshirë

Kjo Marrëveshje zbatohet për personat që janë me banim të përhershëm në një ose në të dy shtetet kontraktuese.

Neni 2

Tatimet e përfshira

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, të caktuara në emër të një shteti kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra që mbliidhen.

2. Konsiderohen si tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e caktuara mbi të ardhurat e plota, mbi kapitalin e plotë ose mbi elementet e të ardhurave ose të kapitalit, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme, tatimet mbi shumat e plota të pagave ose shpërblimeve të paguara nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi shtimin e vlerës së kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja janë, veçanërisht:

- në Shqipëri:

a) tatimet mbi të ardhurat (duke përfshirë tatimet mbi fitimet e ndërmarrjeve dhe tatimet mbi të ardhurat personale);

b) tatimet mbi veprimtaritë e biznesit të vogël; dhe

c) tatimet mbi pasurinë;

(këtu quhen: “tatime shqiptare”);

- në Bosnjë dhe Hercegovinë:

- a) tatimi mbi fitimet e ndërmarrjeve;
- b) tatimi mbi të ardhurat personale;
- c) tatimi mbi pasurinë;

(këtu quhen: “tatimet e Bosnjës dhe Hercegovinës”).

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu edhe për çdo tatim të njëjtë ose thelbësisht të ngjashëm që vihet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të rëndësishëm që është bërë në ligjet e tyre mbi tatimet.

Neni 3

Përkufizime të përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) termat “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” janë Bosnja dhe Hercegovina ose Shqipëria, siç e kërkon konteksti;

b) termi “Shqipëri” është Republika e Shqipërisë, dhe nëse përdoret në një kuptim gjeografik do të thotë territori i Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë që, sipas ligjeve të saj dhe të drejtës ndërkombëtare, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin detar dhe nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

c) termi “Bosnja dhe Hercegovina” është territori i Bosnjës dhe Hercegovinës, duke përfshirë zonën mbi detin territorial, që sipas ligjit të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare është përcaktuar ose do të përcaktohet në të ardhmen, si dhe zona mbi të cilën Bosnja dhe Hercegovina ushtron të drejtat sovraane dhe juridiksionin e saj;

d) termi “nënndarje politike” në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës janë njësitë: Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republika Serbska, dhe Rrethi Brcko i Bosnjës, dhe Hercegovinës;

e) termi “shtetas”, në lidhje me një shtet kontraktues, është:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, partneritet ose shoqatë që e merr statusin e saj si e tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues;

f) termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo bashkim tjetër personash;

g) termi “shoqëri” është një subjekt ligjor që trajtohet si një person juridik për qëllimet tatimore;

h) termi “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” është një ndërmarrje e drejtuar nga një person me vendbanim të përhershëm i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrje e drejtuar nga një person me vendbanim të përhershëm e shtetit tjetër kontraktues;

i) termi “trafik ndërkombëtar” është çdo lloj transporti me anije, mjet lundrimi, avion ose automjet rrugor i operuar nga një ndërmarrje që ka vendin e menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveç kur një anije, mjet lundrimi, avion ose automjet rrugor operohet vetëm ndërmjet vendeve në shtetin tjetër kontraktues;

j) termi “autoritet kompetent” është:

- në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministria e Financave dhe Thesarit të Bosnjës dhe Hercegovinës ose përfaqësuesi i saj i autorizuar;

- në rastin e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. Në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes nga një shtet kontraktues, çdo term që nuk është i përkufizuar atje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ai ka në atë moment sipas ligjit të atij shteti për qëllimin e tatimeve për të cilat zbatohet Marrëveshja, çdo kuptim në bazë të ligjeve të zbatueshme për tatimet e atij shteti që mbizotëron mbi kuptimin e dhënë termit në bazë të ligjeve tjera të atij shteti.

Neni 4

Person me vendbanim të përhershëm

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues” është një person që, sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve të atjeshme për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriter tjetër

të një natyre të ngjashme dhe përfshin gjithashtu atë shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që u nënshtrohet tatimeve në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet ose kapitalin që ndodhet në to.

2. Nëse në bazë të dispozitave të paragrafit 1 një individ është person me vendbanim të përhershëm në të dy shtetet kontraktues, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) ai konsiderohet të jetë person me vendbanim të përhershëm vetëm në shtetin në të cilin ai zotëron një banesë të përhershme; nëse ai zotëron një banesë të përhershme në të dy shtetet, ai konsiderohet të jetë person me vendbanim të përhershëm vetëm në shtetin me të cilin marrëdhëniet e tij personale dhe ekonomike janë më të ngushta (qendër e interesave jetësore);

b) nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetësore nuk mund të përcaktohet, apo nëse ai nuk zotëron një banesë të përhershme në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë person me vendbanim të përhershëm vetëm i shtetit në të cilin ai ka vendqëndrimin e zakonshëm;

c) nëse ai ka një vendqëndrim të zakonshëm në të dy shtetet ose në asnjë prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese vendosin në lidhje me çështjen me marrëveshje të përbashkët.

3. Nëse në bazë të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ është person me vendbanim të përhershëm në të dy shtetet kontraktuese, ai konsiderohet të jetë person me vendbanim të përhershëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit të tij efektiv.

Neni 5

Selia e përhershme

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” është një vend i caktuar i aktivitetit tregtar, nëpërmjet të cilit zhvillohet plotësisht ose pjesërisht veprimtaria tregtare e një ndërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin veçanërisht:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe

f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurore ose një vend tjetër për nxjerrjen e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përhershme” po ashtu përfshin:

a) një kantier ndërtimi, një ndërtim, impiant ose projekt instalimi apo aktivitete mbikëqyrjeje në lidhje me to, por vetëm nëse ky kantier ndërtimi, projekt apo aktivitete vazhdojnë për një periudhë prej më shumë se dymbëdhjetë muaj duke filluar ose mbaruar në vitin fiskal përkatës, dhe

b) dhënie e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulencës, nga një ndërmarrje nëpërmjet të punësuarve ose personeli tjetër të angazhuar nga kjo ndërmarrje për këtë qëllim, por vetëm nëse aktivitetet e kësaj natyre vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që mbledhen në më shumë se gjashtë muaj së bashku, në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore që fillon ose mbaron në vitin fiskal përkatës.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllimin e magazinimit ose ekspozimit të mallrave ose sendeve që i takojnë ndërmarrjes;

b) mirëmbajtjen e gjendjes së mallrave ose sendeve që i takojnë ndërmarrjes vetëm për qëllimin e magazinimit ose ekspozimit;

c) mirëmbajtjen e gjendjes së mallrave ose sendeve që i takojnë ndërmarrjes vetëm për qëllimin e përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mirëmbajtjen e një baze fikse të aktivitetit tregtar vetëm për qëllimin e blerjes së mallrave ose sendeve ose për mbledhjen e informacionit për ndërmarrjen;

e) mirëmbajtjen e një baze fikse të aktivitetit tregtar vetëm për qëllimin e kryerjes së një aktiviteti tjetër të karakterit përgatitor ose ndihmës për ndërmarrjen;

f) mirëmbajtjen e një baze fikse të aktivitetit tregtar vetëm për një kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e” të këtij paragrafi, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i

bazës fikse të aktivitetit tregtar që rrjedh nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, nëse një person - i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6 - vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka, dhe zakonisht ushtron, në një shtet kontraktues një autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, kjo ndërmarrje konsiderohet të ketë një seli të përhershme në atë shtet në lidhje me aktivitetet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e këtij personi janë të kufizuara në ato të përmendura në paragrafin 4 që, nëse ushtrohen nëpërmjet një baze fikse të aktivitetit tregtar, nuk do ta bënte këtë bazë fikse të aktivitetit tregtar një seli të përhershme në bazë të dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk konsiderohet të ketë një seli të përhershme në një shtet kontraktues thjesht meqë ajo zhvillon një biznes në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjent me autorizim të përgjithshëm ose një agjent tjetër me një status të pavarur, me kusht që këta persona të veprojnë në ushtrim të zakonshëm të aktivitetit të tyre.

7. Fakti që një shoqëri që është rezidente në një shtet kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një shoqëri që është rezidente në shtetin tjetër kontraktues, ose që zhvillon aktivitet tregtar në shtetin tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme apo ndryshe), nuk përbën as shoqëri dhe as seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme

1. Të ardhurat e përftuara nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues nga pasuria e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pylltaria) që ndodhet në shtetin tjetër kontraktues mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ai ka në bazë të ligjit të shtetit kontraktues ku gjendet pasuria në fjalë. Termi përfshin në çdo rast pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, blegtorinë dhe pajisjet që përdoren në bujqësi dhe pylltari, të drejtat mbi të cilat zbatohen dispozitat e ligjit të zakonshëm në lidhje me pronësinë mbi tokën, uzufruktin mbi pasurinë e paluajtshme dhe të drejtat për pagesa variable ose fikse, në lidhje me shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar, depozitat minerale dhe burimet e tjera natyrore. Anijet, mjetet lundruese, avionët dhe automjetet rrugore nuk konsiderohen si pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në një formë tjetër të pasurisë së paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje dhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme që përdoret për kryerjen e shërbimeve të pavarura personale.

Neni 7

Fitimet nga aktiviteti tregtar

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon aktivitet tregtar në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet atje. Nëse ndërmarrja zhvillon aktivitet tregtar siç thuhet më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm në masën që ato i takojnë selisë së përhershme.

2. Në pajtim me dispozitat e paragrafit 3, nëse një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon aktivitet tregtar në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet atje, në secilin shtet kontraktues kësaj selie të përhershme i vishen fitimet që ajo pritej të kishte nëse do të ishte një ndërmarrje e zakonshme dhe e shkëputur e përfshirë në aktivitetet e njëjta ose të ngjashme, në kushte të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që shkaktohen për qëllimet e selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet operative dhe administrative të përgjithshme të shkaktuara në këtë mënyrë, në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose gjatë.

4. Në masën që ka qenë e zakonshme në një shtet kontraktues për të përcaktuar fitimet që i vishen një selie të përhershme mbi bazën e ndarjes së fitimeve të përgjithshme të ndërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, asgjë në paragrafin 2 nuk e pengon atë shtet kontraktues për caktimin e fitimeve që duhet të taten nga një ndarje e tillë që është e zakonshme. Metoda e zbatuar e ndarjes do të jetë e tillë që rezultati të jetë në pajtim me parimet që parashikohen në këtë nen.

5. Asnjë fitim nuk i vishet një selie të përhershme për shkak të thjesht blerjes nga kjo seli e përhershme e mallrave ose sendeve për ndërmarrjen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që i vishen selisë së përhershme përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përveç kur ka arsye të besueshme dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

7. Nëse fitimet përfshijnë zëra të të ardhurave që trajtohen veçmas në nene të tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e këtyre neneve nuk ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Trafiku ndërkombëtar

1. Fitimet nga operimi i anijeve, mjeteve lundruese, avionëve ose automjeteve rrugore janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin gjendet ambienti i menaxhimit efektiv i ndërmarrjes.

2. Nëse ambienti i menaxhimit efektiv i një ndërmarrjeje anijesh ose të një trafiku ujor të brendshëm gjendet në bordin e një anijeje ose mjeti lundrimi, ai konsiderohet të ndodhet në shtetin kontraktues në të cilin gjendet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose mjetit të lundrimit, ose nëse nuk ka port të tillë, në shtetin kontraktues ku operatori i anijes ose mjetit të lundrimit është me vendbanim të përhershëm.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një bashkësi, aktivitet tregtar të përbashkët ose një agjenci operative ndërkombëtare.

Neni 9

Ndërmarrje të lidhura ekonomikisht

1. Nëse:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues,

dhe në çdo rast vihen apo caktohen kushte ndërmjet të dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të viheshin ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, të gjitha fitimet që do të ishin përftuar nga një prej ndërmarrjeve në mungesë të këtyre kushteve, por që për shkak të këtyre kushteve nuk janë përftuar, mund të përfshihen në fitimet e kësaj ndërmarrjeje dhe të taten përkatësisht.

2. Nëse një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe taton përkatësisht fitimet për të cilat është tatuar një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues në këtë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin përftuar nga ndërmarrja e shtetit të parë nëse kushtet e caktuara ndërmjet dy ndërmarrjeve do të ishin ato që do të caktoheshin ndërmjet dy ndërmarrjeve të pavarura, shteti tjetër bën një rregullim të përshtatshëm në tatimet e vendosura atje mbi ato fitime. Në caktimin e këtij rregullimi vëmendje e duhur u kushtohet dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultojnë njëri-tjetrin.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri që është me vendqëndrim të përhershëm në një shtet kontraktues një personi me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten edhe në shtetin kontraktues ku shoqëria që

paguan dividendët ka vendqëndrimin e përhershëm dhe në pajtim me ligjet e atij shteti, por nëse përfutuesi është pronari përfutues i dividendëve, tatimi i caktuar nuk kalon:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve nëse pronari përfutues është një shoqëri (e ndryshme nga partneritet) që zotëron drejtpërdrejt të paktën 25% të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese caktojnë me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk ndikon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhet dividendët.

3. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen nënkupton të ardhurat nga aksionet, të drejta të tjera që nuk janë kërkesa për borxhet, pjesëmarrje në fitime, si dhe të ardhurat nga të drejtat e tjera të ndërmarrjes që i nënshtrohet të njëjtit trajtim tatimi si të ardhurat nga aksionet sipas ligjeve të shtetit ku shoqëria që bën shpërndarjen ka vendqëndrim të përhershëm.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfutues i dividendëve që është me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, zhvillon aktivitet tregtar në shtetin tjetër kontraktues ku shoqëria që paguan dividendët ka vendqëndrimin e përhershëm, nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet atje, ose kryhen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe zotërimi në lidhje me të cilin janë paguar dividendë është i lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme ose një bazë fikse. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.

5. Nëse një shoqëri që ka vendqëndrim të përhershëm në një shtet kontraktues përfiton fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ky shtet tjetër nuk mund të caktojë asnjë tatim mbi dividendët e paguar nga ajo shoqëri, përveç deri në masën që këta dividendë i paguhet një personi me vendbanim të përhershëm në atë shtet tjetër, ose në masën që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhet dividendët është efektivisht e lidhur me një seli të përhershme ose një bazë fikse që ndodhet në atë shtet tjetër, dhe as mund t’ia nënshtrojë shoqërisë fitimet e pashpërndara një tatim për fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht nga fitime ose të ardhura që dalin në këtë shtet tjetër.

Neni 11

Interesi

1. Interesi që del në një shtet kontraktues dhe i paguhet një personi me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, një interes i tillë mund të tatohet gjithashtu në shtetin kontraktues në të cilin ai ka dalë dhe në pajtim me ligjet e atij shteti, por nëse përfutuesi është pronari përfutues i interesit tatimi i vendosur nuk kalon 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, caktojnë me marrëveshje të përbashkët mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “interes” i përdorur në këtë nen do të thotë të ardhura nga pretendimet e borxheve të çdo lloji, qofshin të siguruara me hipotekë ose jo dhe pavarësisht nëse kanë të drejtën për të marrë pjesë në fitimet e debitorit, dhe veçanërisht, të ardhurat nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhurat nga bonot ose letrat e borxhit, duke përfshirë premiot dhe çmimet që u bashkohen këtyre letrave me vlerë, bonove ose letrave të borxhit. Kamatëvonesat për pagesat e vonuara nuk konsiderohen si interes për qëllimin e këtij neni.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfutues i interesit, duke qenë me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues në të cilin del interesi, nëpërmjet një selie të përhershme që gjendet atje, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë fikse që gjendet atje, dhe pretendimi për borxhet në lidhje me të cilin paguhet interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.

5. Interesi konsiderohet të dalë në një shtet kontraktues nëse pagesi është shteti vetë, një nënndarje politike, autoritet lokal ose një person me vendbanim të përhershëm në atë shtet. Megjithatë, nëse personi që paguan interesin, qoftë me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues ose jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilin ka lindur borxhi për të cilin paguhet interesi dhe ky interes i vishet selisë së përhershme ose bazës fikse, ky

interes konsiderohet të dalë në shtetin ku gjendet selia e përhershme ose baza fikse.

6. Nëse për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues të interesit ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke pasur parasysh pretendimin e borxhit për të cilin paguhet, e kalon shumën për të cilën do të bihej dakord ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues të interesit në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e fundit. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme në pajtim me ligjet e secilit shtet kontraktues, ku merren parasysh rregullisht dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12 **Honorarët**

1. Honorarët që dalin në një shtet kontraktues dhe i paguhen një personi me banim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në atë shtet.

2. Megjithatë, këta honorarë mund të taten gjithashtu në shtetin kontraktues ku ato dalin në pajtim me ligjet e këtij shteti, por nëse përftuesi është pronari përfitues i honorarëve tatimi i caktuar në këtë mënyrë nuk i kalon 10 për qind të shumës bruto të honorarëve. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e caktojnë mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi me marrëveshje të përbashkët.

3. Termi “honorarë” siç përdoret në këtë nen janë pagesat e çdo lloji që merren duke pasur parasysh përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprave letrare, artistike, shkencore duke përfshirë filmat kinematografikë ose filmat apo regjistrimet e përdorura për transmetim në radio ose televizion, çdo patentë, markë tregtare, disenjoje ose modeli, plani, formule sekrete ose procesi, ose për përdorimin ose të drejtën për të përdorur pajisjet industriale, tregtare ose shkencore, ose për informacionin në lidhje me eksperiencën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i honorarëve, duke qenë me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, zhvillon aktivitet tregtar në shtetin tjetër kontraktues në të cilin dalin honorarët, nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet atje, ose jep në atë shtet tjetër shërbime të pavarura personale nga një bazë fikse që ndodhet atje, dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilën paguhen honorarët është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme ose një bazë fikse. Në një rast të tillë, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.

5. Honorarët konsiderohen të dalin në një shtet kontraktues kur pagesi është vetë ai shtet, një nënndarje politike ose autoritet lokal, ose person me vendbanim të përhershëm në atë shtet. Megjithatë, nëse personi që paguan honorarët, qoftë me banim të përhershëm në një shtet kontraktues ose jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilin, ka lindur detyrimi për të paguar honorarët, dhe këto honorarë përballohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, këta honorarë konsiderohen të dalin në shtetin në të cilin ndodhen selia e përhershme ose baza fikse.

6. Nëse për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues të honorarëve ose ndërmjet tyre dhe një personi tjetër, shuma e honorarëve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato paguhen, e kalon shumën që do të ishte rënë dakord ndërmjet pagesit dhe pronarit përfitues në mungesë të një marrëdhënieje të tillë, dispozitat e këtij neni zbatohen vetëm për shumën e fundit. Në një rast të tillë, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme në pajtim me ligjet e secilit shtet kontraktues, ku merren parasysh rregullisht dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13 **Fitimet nga kapitali**

1. Fitimet që përfitohen nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, të përmendur në nenin 6, dhe që ndodhet në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që është pjesë e pasurisë së aktivitetit tregtar të një selie të përhershme që ka një ndërmarrje e një shteti kontraktues në shtetin tjetër Kontraktues ose të pasurisë së luajtshme që i takon një baze fikse të zotëruar nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve

personale të pavarura, duke përfshirë ato fitime nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen) ose i kësaj baze fikse, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve, mjeteve lundruese, avionëve ose automjeteve rrugore të operuara në trafikun ndërkombëtar ose i pasurisë së luajtshme që i takon operimit të këtyre anijeve, mjeteve të lundrimit, avionëve ose automjeteve rrugore janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të gjendjes së kapitalit të një shoqërie, ose i një interesi në një partneritet ose trust, pronësia e të cilit përbëhet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt kryesisht nga pasuri e paluajtshme e ndodhur në një shtet kontraktues mund të tatohen në atë shtet.

5. Fitimet nga tjetërsimi i një pasurie të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 tatohen vetëm në shtetin kontraktues ku tjetërsuesi ka vendbanimin e përhershëm.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e përftuara nga një individ që është me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në lidhje me shërbime profesionale ose të tjera të ngjashme të një karakteri të pavarur janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç se në rrethanat e mëposhtme, kur këto të ardhura mund të tatohen edhe në shtetin tjetër kontraktues:

a) nëse ai zotëron rregullisht një bazë fikse në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të tij; në atë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i vishet bazës fikse mund të tatohet në atë shtet tjetër; ose

b) nëse qëndrimi i tij në shtetin tjetër kontraktues është për një periudhë ose periudha që janë të barabarta ose që në tërësi kalojnë shumën 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore që fillon ose mbaron në vitin kalendarik përkatës; në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që rrjedh nga aktivitetet e tij të kryera në atë shtet tjetër mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin veçanërisht aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, edukative ose mësimdhënëse, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, dentistëve, juristëve, inxhinierëve, arkitektëve, auditëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

Shërbimet personale të varura

1. Në pajtim me dispozitat e neneve 16, 18, 19 dhe 21 të kësaj Marrëveshjeje, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të përftuara nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në lidhje me një punësim tatohet vetëm në atë shtet, përveç kur punësimi ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përfitohet prej atje mund të tatohet në shtetin tjetër.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, shpërblimi i përftuar nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në lidhje me një punësim që ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) përftuesi është i pranishëm në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në tërësi 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetëmujore që fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga, ose në emër të një punëdhënësi që nuk është me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk mbahet nga një seli e përhershme ose një bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përftuar në lidhje me një punësim të zhvilluar në bordin e një anijeje, mjeti lundrues ose avioni që operohet në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në shtetin kontraktues ku ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

Neni 16

Honorarët e drejtorit

Honorarët e drejtorit dhe pagesa të tjera të ngjashme, që përftohen nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtorëve të një shoqërie që është me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e përfuara nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, si artist teatri, filmi, radioje ose televizioni, ose muzikant apo sportist nga aktivitetet e tij personale, se të tillë të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues.

2. Nëse të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në cilësinë e tij si i tillë nuk i kalojnë artistit ose sportistit vetë por një personi tjetër, këto të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15 të kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e artistit ose sportistit.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2, të ardhurat e përfuara nga një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues nga aktivitetet e tij personale si artist ose sportist tatohen vetëm në atë shtet nëse aktivitetet ushtrohen në shtetin tjetër kontraktues brenda kuadrit të një programi shkëmbimi kulturor dhe sportiv të aprovuar nga të dy shtetet kontraktues.

Neni 18

Pensionet

Në pajtim me dispozitat e paragrafëve 2 të nenit 19 të kësaj Marrëveshjeje, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara një personi me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në lidhje me punësimin e tij të shkuar janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimi qeveritar

1. a) Pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, të ndryshme nga pensioni, që i paguhen nga një shtet kontraktues ose një nënndarje e tij politike apo një autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e dhëna atij shteti ose nënndarjeje apo autoriteti janë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga dhe shpërblime të tjera të ngjashme janë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues nëse shërbimet jepen në atë shtet dhe individ është me vendbanim të përhershëm në atë shtet që:

- është shtetas i atij shteti; ose

- nuk është bërë shtetas i atij shteti vetëm për qëllimin e dhënies së shërbimeve.

2. a) Çdo pension i paguar nga, ose nga fondet e krijuara nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike apo autoritet lokal i tij një individ në lidhje me shërbimet e dhëna atij shteti ose nënndarjeje ose autoriteti lokal tatohet vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, ky pension tatohet vetëm në shtetin tjetër kontraktues nëse individ është me vendbanim të përhershëm atje ose është shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme dhe pensionet e paguara në lidhje me një veprimtari tregtare të ushtruar nga një shtet kontraktues, nënndarjet politike ose autoritetet lokale të tij.

Neni 20

Studentët dhe praktikantët

1. Pagesat që një student ose praktikant në aktivitet tregtar që është ose ishte para vizitës në shtetin kontraktues me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues dhe që është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllimin e arsimimit ose trajnimit të tij, çdo pagesë që ai merr për qëllimin e qëndrimit, arsimimit ose trajnimit nuk tatohet në atë shtet, me kusht që këto pagesa të vijnë nga burime jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me grantet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, një student ose praktikant në një aktivitet tregtar i përmendur në paragrafin 1, përveç kësaj, ka të drejtën që gjatë këtij arsimimi ose trajnimit për të gjitha përjashtimet, lehtësimet ose zbritjet në lidhje me tatimet që janë për personat me vendbanim të përhershëm në shtetin kontraktues që ai po viziton.

Neni 21

Profesorët dhe kërkuesit

1. Një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues që, me ftesë të një universiteti, kolegji, shkolle ose institucioni tjetër të ngjashëm, që gjendet në shtetin tjetër kontraktues dhe që njihet nga qeveria e atij shteti kontraktues, është përkohësisht i pranishëm në shtetin tjetër kontraktues vetëm për qëllimin e mësimdhënies ose përfshirjes në kërkime, apo për të dyja, në institucionin edukativ, për një periudhë që nuk i kalon dy vjet nga data e mbërritjes së tij të parë në shtetin tjetër kontraktues, mund të përjashtohet nga tatimet në shtetin tjetër kontraktues në lidhje me shpërblimin e tij për këtë mësimdhënie ose kërkim.

2. Nuk bëhet asnjë përjashtim në bazë të paragrafit 1 në lidhje me një shpërblim për kërkimin nëse ky kërkim ndërmerret jo për interes publik, por për përfitim privat të një ose disa personave të caktuar.

Neni 22

Të ardhura të tjera

1. Zërat e të ardhurave të një personi me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, kudo që lindin, që nuk parashikohen në nenet e mësipërme të kësaj Marrëveshjeje taten vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për të ardhurat, të ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e patundshme sipas përkufizimit në paragrafin 2 të nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje, nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues, zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet atje, ose kryhen shërbime të pavarura personale në shtetin tjetër nga një bazë fikse që gjendet atje, dhe e drejta ose pronësia në lidhje me të cilat paguhen këto të ardhura është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14 të kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit.

Neni 23

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuria e patundshme e përmendur në nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje në pronësi të një personi me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues dhe që gjendet në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në shtetin tjetër.

2. Kapitali, i përfaqësuar nga pasuria e tundshme, që është pjesë e një prone të aktivitetit tregtar të një selie të përhershme që ka një ndërmarrje e një shteti kontraktues në shtetin tjetër kontraktues ose nga pasuria e tundshme që i takon një baze fikse që i përket një personi me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues në shtetin tjetër kontraktues për qëllimin e kryerjes së shërbimeve të pavarura personale, mund të taten në shtetin tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet, avionët dhe automjetet rrugore të operuara në trafikun ndërkombëtar dhe nga mjetet lundruese të angazhuara në trafikun e ujërave të brendshme dhe nga pasuria e tundshme që i takon operimit të këtyre anijeve, mjeteve lundruese, avionëve dhe automjeteve rrugore, taten vetëm në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një personi me vendbanim në një shtet kontraktues taten vetëm në atë shtet.

Neni 24

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Tatimi i dyfishtë eliminohet si më poshtë:

a) Nëse një person me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues merr të ardhura ose ka në pronësi kapital që, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në shtetin tjetër kontraktues, shteti kontraktues i parë lejon:

- si një zbritje nga tatimet mbi të ardhurat e atij personi me vendbanim të përhershëm, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat që paguhet në atë shtet tjetër kontraktues;

- si një zbritje nga tatime mbi kapitalin e atij personi me vendbanim të përhershëm, një shumë të barabartë me taksën mbi kapitalin që paguhet në atë shtet tjetër kontraktues.

Një zbritje e tillë në asnjë rast nuk kalon atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose tatimin mbi kapitalin, sipas llogaritjes para se të bëhet zbritja, që i takon, sipas rastit, të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në atë shtet tjetër kontraktues.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje të ardhurat e përfuara ose kapitali në pronësi të një personi me vendbanim në një shtet kontraktues janë të përjashtuara nga tatimi në atë shtet, shteti kontraktues, megjithatë, gjatë përllogaritjes së tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave ose kapitalit të këtij personi me vendbanim të përhershëm, mund të marrë parasysh të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

2. Nëse, në bazë të ligjeve të një shteti kontraktues një tatim për të cilin zbatohet kjo Marrëveshje është përjashtuar ose pakësuar për një periudhë të caktuar kohe për të nxitur zhvillimin ekonomik në atë vend, për qëllimet e paragrafit 1, ky tatim mendohet të jetë paguar.

Neni 25

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen në shtetin tjetër kontraktues asnjë tatimi ose kërkesë që ka të bëjë me të, që është më e rëndë se një tatim ose kërkesë përkatëse që i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin e përhershëm. Kjo dispozitë, pavarësisht dispozitave të nenit 1, zbatohet edhe për personat që nuk janë me vendbanim të përhershëm në një ose të dy shtetet kontraktuese.

2. Personat pa shtetësi që janë me vendbanim të përhershëm në një shtet kontraktues nuk i nënshtrohen në asnjë shtet kontraktues asnjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që është i ndryshëm ose më i rëndë se tatimi dhe kërkesat përkatëse që i nënshtrohen ose mund t'i nënshtrohen shtetasit e atij shteti tjetër në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me vendbanimin e përhershëm.

3. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues nuk caktohet më pak i favorshëm në atë shtet tjetër se tatimi që caktohet mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillojnë të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk interpretohet si detyrim për një shtet kontraktues për t'u dhënë shtetasve me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues tarifa, lehtësira ose reduktime personale për qëllime tatimi në sajë të gjendjes civile ose përgjegjësiive familjare që ai u jep personave me vendbanim të përhershëm atje.

4. Përveç kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 neni 9, paragrafi 6 neni 11, ose paragrafi 6 neni 12, interesi, honorarët ose disbursime të tjera që i paguheshin nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllimin e caktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, zbriten në të njëjtat kushte sikur t'i paguheshin një personi me vendbanim të përhershëm në shtetin e parë. Po kështu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues ndaj një personi me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues, për qëllimin e caktimit të kapitalit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, zbritet në të njëjtat kushte sikur t'i ishte kontraktuar një personi me vendbanim të përhershëm në shtetin e parë.

5. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është plotësisht ose pjesërisht në pronësi ose i kontrolluar drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt nga një ose më shumë persona me vendbanim të përhershëm në shtetin tjetër kontraktues nuk i nënshtrohen asnjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të në shtetin e parë që është më i rëndë se tatimi ose kërkesat përkatëse që i nënshtrohet ose mund t'i nënshtrohen ndërmarrjet e tjera të ngjashme të shtetit të parë.

6. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, zbatohen për tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi.

Neni 26

Procedura e marrëveshjes së përbashkët

1. Nëse një person mendon që veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në një tatim që nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente, ai, pavarësisht mjeteve ligjore të parashikuara nga ligji i brendshëm i atyre shteteve, mund ta paraqesë çështjen e tij para autoritetit kompetent të shtetit kontraktues ku ai ka vendbanimin e përhershëm ose, nëse çështja e tij rregullohet nga paragrafi 1 i nenit 24, tek ai i shtetit kontraktues shtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatim në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoriteti kompetent përpiqet nëse kundërshtimi duket i arsyetuar dhe nuk është vetë në gjendje të arrijë një zgjidhje të pranueshme, të zgjidhë çështjen me marrëveshje të përbashkët me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim mënjanimin e tatimit që nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht kufijve kohorë në ligjin e brendshëm të shtetit kontraktues.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të përbashkët çdo vështirësi ose dyshim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato mund të konsultohen gjithashtu së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet që nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëra-tjetrën drejtpërdrejt për qëllimin e arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë çdo informacion që mendohet të jetë i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të caktuara në emër të shteteve kontraktuese ose nënndarjet e tyre apo autoritetet lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar në bazë të ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u jepet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që kanë të bëjnë me vlerësimin ose mbledhjen, ekzekutimin ose ndjekjen penale për to, vendimin për ankimet në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen sa më sipër. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në procedime gjyqësore ose në vendime gjyqësore.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur caktojnë mbi një shtet kontraktues detyrimin:

- a) për të zbatuar masa administrative në kundërshtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;
- b) për të dhënë informacion që nuk mund të merret sipas ligjeve ose procedurës administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;
- c) për të dhënë informacion që do të nxirrte një të fshehtë tregtare, të biznesit, industriale, profesionale ose proces tregtar, nxjerrja e së cilës do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

Si dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 17 qershor 2008, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqipe, boshnjake/serbe/kroate dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

VENDIM

Nr.217, datë 6.10.2008

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM
MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5903, datë 2.10.2008 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5903, datë 2.10.2008 për shkarkimin e zotit Koço Barka nga detyra e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**VENDIM
Nr.218, datë 6.10.2008**

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5904, datë 2.10.2008 të Presidentit të Republikës

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5904, datë 2.10.2008 për emërimin e zotit Anastas Duro në detyrën e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

**VENDIM
Nr.726, datë 28.5.2008**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E BRENDSHME BASHKISË
KORÇË, TË OBJEKTIT “ISH-REPARTI 741” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS
SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronjat “d” e “k”, 6, 8 e 18, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit) bashkisë Korçë, të objektit “Ish-reparti 741”, për ngritjen e banesave kolektive, për sistemimin e familjarëve të policëve të rënë në detyrë dhe të atyre, që aktualisht banojnë në këto mjedise, si dhe për ngritjen e objekteve social-tregtare.

2. Bashkisë së Korçës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1

të këtij vendimi.

3. Pronat me numrat rendorë 496-510, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Brendshme, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
			Ish-Reparti 741						
496				Mencë, ofiçinë, depo, kuzhinë		900	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
497				Magazinë		94.3	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
498				Fjetore nr.3		264	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
499				Fjetore nr.4		264	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
500				Fjetore nr.5		198	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
501				Mikrokampi		220	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
502				Inferemieria		40	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
503				Zyrat e rep 741		210	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
504				Godina nr.1		256	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
505				Godina nr.2		275	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
506				Magazinë veshmbathjeje		198	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
507				Magazinë ushqimore		196	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
508				Repart zdrukthtarie, depo pranë repartit		192	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
509				Vend truproja		56	Banesa familjare	MRP	Familje ushtarakësh
510				Sipërfaqja totale brenda rrethimit		20398	truall	MRP	Familje ushtarakësh

VENDIM
Nr.818, datë 11.6.2008

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË ZHVILLUESIT TË ZONËS EKONOMIKE, NË VLORË, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike” dhe të neneve 4, pika 1, shkronja “g”, 5, pikat 1 e 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Vlorë, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
 2. Miratimin e bonusit prej 5.5 për qind të pikëve, për rezultatin ekonomik, financiar, teknik dhe mjedisor, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Idea Vlora”, sh.a.
 3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1310, datë 6.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1294, DATË 27.9.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007, PËR ÇSHTJEN “RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rreshtin e tretë të pikës 4 të vendimit nr.1294, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale...” hiqen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1311, datë 6.10.2008

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1293, DATË 27.9.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS
EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007, PËR ÇËSHTJEN “DRIZA
KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1293, datë 27.9.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në rreshtin e tretë të pikës 6, fjalët “... nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale,...” hiqen.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 3 të vendimit, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.”.

3. Numri rendor 7 bëhet 8.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

**VENDIM
Nr.1315, datë 1.10.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGËN TË PUNONJËSVE
SHQIPTARË PËR KOHËN, QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS, PRANË
QENDRËS SECI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit shqiptarë, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Financave, për kohën, që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës, pranë Qendrës SECI, trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e nëpunësve ndërlidhës, njësohet me pagën e gradës “Këshilltar”, në shërbimin e jashtëm.

2. Nëpunësit ndërlidhës, për kohën që shërbejnë pranë Qendrës SECI, përfitojnë edhe kompensim për koston e jetesës, në masën 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro.

3. Paga e nëpunësit ndërlidhës fillon nga data e mbërritjes së tij pranë Qendrës SECI. Deri në këtë çast, ai trajtohet me pagën ekzistuese të vendit të tij të mëparshëm të punës.

4. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Në bazë të pagës mujore paguhet edhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

5. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit, në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

6. Pikat 7 e 8 të vendimit nr.129, datë 15.3.2001 të Këshillit të Ministrave “Për përfaqësimin e

Republikës së Shqipërisë në Qendrën Rajonale të Nismës së Bashkëpunimit për Europën Juglindore (Qendra SECI), për luftën kundër krimit ndërkufitar”, shfuqizohen.

7. Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave, brenda fondeve buxhetore vjetore, të parashikuara në ligjin e buxhetit të vitit përkatës kalendarik, të përballojnë shpenzimet për pagat e nëpunësve ndërlidhës.

8. Ngarkohen Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**PAGA MUJORE E NËPUNËSVE NDËRLIDHËS TË MINISTRISË SË BRENDSHME E TË
MINISTRISË SË FINANCIVE PRANË QENDRËS SECI**

Pozicioni	Paga mujore	
	Paga bazë mujore në euro	Shtesë për përfaqësimin në %
Nëpunës ndërlidhës	780 euro	40%

**VENDIM
Nr.22, datë 7.10.2008**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 24.7.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.16 Akti, që i përket:

KËRKUES: ALFRED SULAJ, përfaqësuar nga av.Skënder Demiraj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.729, datë 28.5.2008 “Për shkarkimin nga detyra e kryetarit të komunës Kashar”.

BAZA LIGJORE: Neni 115/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi ka qenë i zgjedhur si kryetar i komunës Kashar. Në datën 28.5.2008, Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar nga detyra për shkelje të rënda të ligjit. Duke mos qenë dakord, kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.729, datë 28.5.2008, për shkarkimin e tij nga detyra.

Gjatë gjykimit është konstatuar se vendimi për shkarkimin e tij i është dërguar këshillit të komunës Kashar në datën 18.6.2008 dhe është depozituar ne protokollin e komunës me datë 20.6.2008. Kërkuesi ka marrë dijeni me datë 25.6.2008. Kërkesa është depozituar pranë Gjykatës Kushtetuese me datë 26.6.2008.

Kërkuesi, për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.729, datë 28.5.2008, ka parashtruar këto shkaqe:

- Nuk është respektuar parimi i prezumimit të pafajësisë, sepse është shkarkuar nga detyra vetëm për faktin se ndaj tij është filluar çështja penale e falsifikimit të dokumenteve zyrtare, pa pritur që gjykata kompetente të shprehej me vendim të formës së prerë për fajësinë e tij.

- Këshilli i Ministrave nuk ka argumentuar në vendimin e tij shkelje të tjera, përveç atyre për të cilat kërkuesi është në ndjekje penale për akuzën e falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

- Këshilli i Ministrave ka shkelur nenin 42 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin e qeverisjes vendore”, sepse ka iniciuar këtë proces shkarkimi me propozim të këshillit komunal mbështetur në shkronjën “c” të nenit 42 të ligjit dhe më pas e ka mbështetur në shkronjën “a” të nenit 42 të ligjit.

Subjekti i interesuar ka pretenduar si shkak për rrëzimin e kërkesës se:

- Kërkuesi është jashtë afatit kushtetues 15-ditor për paraqitjen e ankimit në Gjykatën Kushtetuese, përcaktuar nga neni 115/2 i Kushtetutës.

- Ai ka kryer shkelje të rënda të ligjit dhe Kushtetutës.

II

Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykimi i çështjeve të tilla ka për objekt një akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë buron nga një dispozitë konkrete kushtetuese (neni 115/2) dhe përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese shqyrton drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ (*shih vendimin nr.39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

Vendimi për shkarkimin nga detyra të organit të qeverisjes vendore është akt individual i një natyre administrative. Aktet administrative, përfshirë edhe aktet e Këshillit të Ministrave (përveç akteve administrative me natyrë normative dhe atyre që kanë rregullim ligjor të posaçëm), kundërshtohen pranë gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutbërësi, në mënyrë që t’u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, ka përcaktuar Gjykatën Kushtetuese si organ kompetent për shqyrtimin e kërkesës. Ky gjykim, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës, sepse Kushtetuta ka sanksionuar se organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore mund të shpërndahet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave edhe për shkelje të rëndë të ligjit apo Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të ligjit apo Kushtetutës, nuk mund të bëjë ndryshe, veçse të hetojë dhe gjykojë në themel çështjen, ashtu siç do vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm.

Në këtë gjykim, secila nga palët ka detyrimet e veta procedurale. Pala kërkuese ka detyrimin të argumentojë karakterin antikushtetues të vendimit, ndërsa pala e interesuar ka detyrimin të përcaktojë veprimet ose mosveprimet që përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe ligjeve.

III

Sipas subjektit të interesuar, kërkuesi ka shkelur afatin 15-ditor të sanksionuar në nenin 115 e Kushtetutës, sepse, sipas tij, ky afat fillon nga dita e daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit dhe jo nga dita e marrjes dijeni të këtij të fundit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesi është në afat për të paraqitur ankim pranë Gjykatës Kushtetuese. Vendimi i Këshillit të Ministrave i është dërguar këshillit të komunës Kashar me datë 18.6.2008 dhe është depozituar ne protokollin e komunës me 20.6.2008. Kërkuesi ka marrë dijeni me datë 25.6.2008 dhe ka depozituar kërkesën pranë Gjykatës Kushtetuese me datë 26.6.2008.

Kërkuesi pretendoi se është shkarkuar nga detyra për shkelje, për të cilat ka filluar procedimi penal, që lidhen me detyrën e tij kur ka qenë kryeplak dhe jo kryetar komune; se nuk është respektuar prezumimi i pafajësisë, pasi Këshilli i Ministrave, ndonëse çështja ka qenë duke u hetuar, e ka prezumuar të fajshëm dhe e ka shkarkuar pa pritur që gjykata kompetente të shprehet për akuzën e bërë ndaj tij nga Prokuroria. Po kështu, ai pretendoi se Këshilli i Ministrave nuk argumenton në vendimin e tij shkelje të tjera veç atyre për të cilat kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria dhe është në ndjekje penale.

Gjatë shqyrtimit të çështjes është provuar se kërkuesi, me cilësinë e kryetarit të komunës Kashar, ka vepruar në kundërshtim me kryerjen e rregullt të funksioneve të tij. Edhe pse zbatimi i ligjit për tokën ka pas përfunduar që në vitet 1996-1997, ai ka urdhëruar që të kryheshin veprime konkrete për të rishpërndarë sipërfaqe të ndryshme toke. Duke vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e ligjit nr.7501, datë 19.1.1991 “Për tokën” dhe me ndryshimet e mëvonshme, ka firmosur disa akte pronësie për shtetas të veçantë. Kështu, kërkuesi ka nënshkruar disa herë dokumentacionin për plane rievimi, siç kanë qenë ai i datës 23.8.2005, i datës 2.5.2007 apo plan rievimi i datës 7.7.2005 apo dhe nënshkrimi i vendosur në shkresën nr.1173, datë 4.3.2008. Në këtë mënyrë, në atë komunë, kanë ardhur pasoja të rënda për interesat private dhe publike, sepse janë kryer mbivendosje e mospërputhje me aktet e pronësisë që ekzistonin në regjistrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këto janë shkelje të karakterit administrativ e disiplinor për të cilat kërkuesi që kishte barrën e provës nuk vërtetoi të kundërtën për sa është pretenduar nga subjekti i interesuar.

Në kundërshtim me sa ka parashtuar kërkuesi, Gjykata konstaton se Këshilli i Ministrave e ka shkarkuar kryetarin e komunës Kashar bazuar në nenin 42/a të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (ligji nr.8652). Sipas shkronjës “a” të këtij neni, kryetari i komunës ose bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Sipas këtij parashikimi jo gjithmonë shkelja e rëndë e ligjeve apo Kushtetutës shoqërohet me përgjegjësi penale, por barra e verifikimit të këtij fakti i takon organit propozues. Në rastin në shqyrtim nuk ka nevojë domosdoshmërisht për një vendim gjyqësor që të deklarojë faktin e shkeljes së rëndë të ligjeve ose Kushtetutës, sepse neni 42, shkronja “b”, parashikon shkarkimin e kryetarit të komunës ose bashkisë shprehimisht për shkak të dënimit për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë të gjykatës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, si rregull, përgjegjësia penale konkurren me përgjegjësinë administrative apo disiplinore. Veç kësaj, pavarësisht nga procedimi penal, organi administrativ, Këshilli i Ministrave, mund të nisë njëherazi një procedurë administrative për shkelje për të cilat konstatohet përgjegjësi administrative.

Gjykata rithekson se nisur nga përmbajtja e nenit 115, pika 1, të Kushtetutës, sipas së cilës Këshilli i Ministrave mund të shkarkojë organin e njësisë së qeverisjes vendore të zgjedhur drejtpërdrejt, kuptimi i saktë dhe i drejtë i konceptit shkelje e rëndë e ligjit, përdorur në këtë dispozitë kushtetuese, vlerësohet në tërësinë e saj nga disa faktorë që kanë të bëjnë me rëndësinë e ligjit të shkelur, pasojat e ardhura nga shkelja e tij, kohëvazhdimin e këtyre pasojave, si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer (*shih vendimet nr.25, datë 4.5.2000 dhe nr.50, datë 31.7.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kërkuesi pretendoi se Këshilli i Ministrave ka shkelur nenin 42 të ligjit nr.8652, sepse ka iniciuar këtë proces shkarkimi me propozim të këshillit komunal, mbështetur në shkronjën “c” të nenit 42 të ligjit dhe më pas e ka mbështetur në shkronjën “a” të po këtij neni pasi nuk ka arritur që të marrë pëlqimin e këshillit komunal për shkarkimin, pëlqim që është kërkesë e nenit 42 shkronja “c” të ligjit.

Ky pretendim nuk është i bazuar, sepse, sipas nenit 42 të ligjit nr.8652, kryetari i komunës ose bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur: a) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve; b) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të formës së prerë nga gjykata; c) propozohet për shkarkim nga këshilli komunal ose bashkiak përkatës për mosparaqitje në detyrë për një periudhë 3-mujore të pandërprerë. Bazuar mbi këtë dispozitë, procedimet administrative për shkarkimin e kryetarit të komunës ose bashkisë mund të bëhen për shkaqe të ndryshme nga organe propozuese të ndryshme. Kështu, në rastin konkret, procedimi i nisur bazuar në pikën “c” të nenit 42, nga këshilli komunal i komunës Kashar është një procedim i pavarur nga procedimi i nisur me propozim të Ministrit të Brendshëm, bazuar në pikën “a” të nenit 42 të ligjit nr.8652.

Sa më lart, Gjykata vlerëson se shkeljet e rënda të ligjit nga ana e kërkuesit si kryetar i

komunës, justifikojnë shkarkimin e tij nga detyra. Në këto rrethana, kërkesa e paraqitur prej tij është e pabazuar në kuptim të nenit 115/2 të Kushtetutës dhe për rrjedhojë, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Xhezair Zaganjori, Gjergj Sauli, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Fehmi Abdiu, Sokol Berberi.

VENDIM

Nr.28, datë 25.9.2008

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR METODOLOGJINË E ANALIZËS SË KOSTOVE TË NDIHMËS SHTETËRORE NË FORMËN E SIGURIMIT AFATSHKURTËR TË KREDIVE TË EKSPORTIT”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “e” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për metodologjinë e analizës së kostove të ndihmës shtetërore në formën e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Genc Ruli

UDHËZIM

PËR METODOLOGJINË E ANALIZËS SË KOSTOVE TË NDIHMËS SHTETËRORE NË FORMËN E SIGURIMIT AFATSHKURTËR TË KREDIVE TË EKSPORTIT

Hyrje

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve, mbi bazën e të cilave mund të jepet ndihma shtetërore në sektorin e sigurimit të kreditimit të eksportit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës midis sigurveve publikë të kredive të eksportit ose të mbështetur publikisht dhe atyre privatë që mund të ushtrojnë veprimtarinë në një treg të tillë.

Ky udhëzim zbatohet në sektorin e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit dhe nuk gjen zbatim për sigurimin afatmesëm dhe afatgjatë të kredive të eksporteve.

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjenci zyrtare” të kredive të eksportit mund të jenë institucione qeveritare, shoqëri me kapital shtetëror, shoqëri që kontrollohen nga shteti ose shoqëri private, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e sigurimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të kredive të eksportit.

2. “Sigurve privat” i kredive të eksportit do të quhet çdo sigurve që ofron kryesisht ose ekskluzivisht sigurim afatshkurtër të kredive të eksportit, por që nuk vepron për llogari të shtetit ose nuk mbështetet prej tij, në asnjë nga veprimtaritë që ushtron.

3. “Sigurve publik ose i mbështetur publikisht” i kredive të eksportit do të quhet çdo agjenci

zyrtare që vepron si në tregun e sigurimit afatshkurtër, ashtu edhe në atë të sigurimit afatmesëm/afatgjatë, si dhe çdo sigurues privat ose që kontrollohet nga privatët, që ofron vetëm sigurim afatshkurtër, që mund të mbështetet gjatë veprimtarisë së tij nga shteti nëpërmjet garancive ose marrëveshjeve ekuivalente të risigurimit.

4. “Rreziqet (risqet) e tregtueshme” janë të përcaktuara si risqe tregtare për debitorët jopublikë. Kohëzgjatja maksimale për këto risqe (përfshin periudhën e fabrikimit plus kohëzgjatjen e kredisë me një kohë fillimi normale dhe me kushte normale kreditimi) është më pak se 2 vjet.

5. “Risk tregtar” është:

a) çdo refuzim i pamotivuar i kontratës nga ana e debitorit, që nënkupton çdo vendim arbitrar të debitorit jopublik për të ndërprerë ose pezulluar kontratën, pa shkaqe të përligjura;

b) çdo refuzim arbitrar i debitorit jopublik, për pranimin e të mirave, objekt i kontratës, pa asnjë shkak ligjor;

c) paafëzia paguese e debitorit jopublik ose e garantuesit të tij;

d) mospagimi nga ana e debitorit jopublik ose nga garantuesi të detyrimeve që rezultojnë në kontratë, kur kjo mospagesë është e zgjatur.

6. “Debitor publik” është ai debitor, që, në një mënyrë apo tjetër, përfaqëson autoritetin publik dhe nuk mundet që as në rrugë gjyqësore, as në rrugë administrative të deklarohet si i paafte për të paguar (të falimentojë). Në këtë kategori përfshihen: banka qendrore, organet e qeverisjes qendrore, si dhe institucionet që varen nga organet qendrore, lokale apo rajonale.

7. “Risk politik” në kuptim të këtij udhëzimi është:

a) çdo vështirësi dhe vonesë në transferimin e valutës së huaj nga vendet debitoare, e pasuar nga një shtyrje e afatit të borxhit të jashtëm, e dhënë nga qeveria e shtetit debitor ose nga qeveria e një shteti të tretë, nëpërmjet të cilit do të bëhet pagesa;

b) çdo veprim i marrë nga qeveria e importuesit, që e bën të pamundur pagesën e plotë ose të pjesshme të mallrave objekt i kontratës;

c) çdo veprim tjetër i marrë nga qeveritë e huaja, që ndalon marrëveshjet e kredive ose përcakton vonesa në transferimin e parave;

d) lufta, lufta civile, revolucion dhe ose çdo ngjarje e ngjashme me të;

e) çdo humbje e lidhur me debitorët publikë;

f) çdo humbje që vjen si pasojë e pamundësisë së vendosjes së procedurave ligjore në vendet debitoare, për shkak të mungesës ose mosfunksionimit të sistemit ligjor apo gjyqësor.

I. Faktorët që ndikojnë në konkurrencë

Faktorët të cilët shtrembërojnë ose mund të shtrembërojnë konkurrencën në tregun e sigurimit afatshkurtër të kredive të eksportit, duke u dhënë siguruesve të caktuar (siguruesit publikë ose të mbështetur publikisht të kredive) të cilët marrin përsipër detyrimin të sigurojnë risqe të tregtueshme për eksport, një përparësi financiare selektive dhe që përbëjnë ndihmë shtetërore, sipas legjislationit të ndihmës shtetërore janë:

a) çdo garanci shtetërore *de jure* ose *de facto* ndaj huamarrjes dhe humbjeve, që u mundëson siguruesve të marrin hua me norma interesi më të ulëta sesa normat normale të tregut ose marrjen hua në para, duke penguar që siguruesit të risigurojnë veten e tyre në tregun privat;

b) çdo diferencim në detyrime, krahasuar me siguruesit privatë, që u mundëson mbajtjen e provigjioneve të përshtatshme;

c) lehtësimi ose përjashtimi nga taksat, normalisht të pagueshme (të tilla si taksat e korporatës dhe detyrimet tatimore mbi politikën e sigurimit);

d) dhënia e ndihmës nga shteti ose injektimi i kapitalit, duke pasur parasysh se pjesëmarrja e shtetit në kapital përbën ndihmë shtetërore vetëm në rast se ai nuk vepron si një investitor privat në një ekonomi tregu;

e) ofrimi nga shteti i shërbimeve, të tilla si: lejimi i përdorimit të infrastrukturës shtetërore, përdorimi i informacionit konfidencial (për shembull, informacioni për debitorët i mbledhur nga ambasadat);

f) risigurimi nga shteti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes një siguruesi publik të kredive për eksport në kushte më të favorshme se ato të ofruara nga tregu privat i risigurimeve, gjë që çon në uljen e çmimit të sigurimit ose krijimin artificial të kapaciteteve, të cilat një investitor privat nuk do t'i siguronte në tregun privat.

II. Lejimi i ndihmës shtetërore

1. Komisioni i Ndihmës Shtetërore mund të lejojë përkohësisht ndihmën shtetërore të dhënë në një nga format e parashikuara në pikën 1, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) Risigurimi i shtetit është një element i vogël në të gjithë paketën e risigurimit për shoqëritë risiguruese;

b) Kur marrëveshjet e risigurimit të shoqërive të sigurimit ndërthurin risqet e tregtueshme dhe të patregtueshme dhe çdo risigurim shtetëror që, në mënyrë të pashmangshme, i shtohet riskut të tregtueshëm, niveli i risigurimit shtetëror për risqet e tregtueshme nuk duhet të tejkalojë atë që është e pranishme në tregun e risigurimit privat, në rast se risigurimi është kërkuar vetëm për këto risqe;

c) Risigurimi i shtetit nuk vepron në mënyrë të tillë që t'i bëjë të mundur siguruesit sigurimin e biznesit për sa i përket blerësve individualë përtej kufijve të vendosur nga risiguruesit pjesëmarrës të tregut privat;

d) Primi për risigurimin shtetëror pasqyron risqet, është i llogaritur në bazë të teknikave të tregut dhe, nëse është e disponueshme një normë primi në një treg të ngjashëm, është, të paktën, e barabartë me atë normë;

e) Risigurimi i shtetit për risqet e tregtueshme është i vlefshëm për të gjithë siguruesit e kredisë, të cilët janë në gjendje të plotësojnë kriterin e përgjithshëm të pranueshmërisë.

2. Siguruesit privatë të kredive të eksportit ose siguruesit publikë, ose të mbështetur publikisht të kredive të eksportit, që veprojnë për llogari të tyre, si pasojë e mungesës së kapacitetit për sigurim apo risigurim, nuk mund të jenë përkohësisht në gjendje të mbulojnë risqet e tregtueshme të kredive të eksportit. Prandaj këto risqe konsiderohen si përkohësisht të patregtueshme.

Në këto raste risqet, përkohësisht të patregtueshme, mund të futen në llogarinë e shoqërive publike ose të mbështetura publikisht të sigurimit të kredive të eksportit që veprojnë për llogari të shtetit apo me anë të garancive të shtetit.

Siguruesi duhet të përafrojë, sa më shumë që të jetë e mundur, normat prim për këto risqe me normat e vendosura nga shoqëritë private të sigurimit të kredive të eksportit për këtë lloj risku.

III. Detyrime të tjera për siguruesit

Siguruesit publikë të kredive të eksportit ose ata që mbështeten nëpërmjet burimeve shtetërore duhet të mbajnë llogari të ndara dhe të administrojnë veçmas sigurimin ndaj risqeve të tregtueshme dhe atyre të patregtueshme, për llogari ose me garancinë (mbështetjen) e shtetit.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.729, datë 11.9.2008, shpall të zhdukur shtetasen Elsa Muharrem Abazaj, të datëlindjes 28.9.1976.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2436, datë 5.9.2008, shpall të vdekur shtetasin Genci Sulejman Doku, të datëlindjes 30.5.1959, me datë vdekjeje 20.12.2004.

KËRKESË

Shtetasja Andoneta Sulko, e bija e Llukanit dhe e Dhoksisë, e datëlindjes 1.6.1964, lindur dhe banuese në lagjen 20 Tetori, Lushnjë, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Pëllumb Sulko.

KËRKUESJA
Andoneta Sulko

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 10.10.2008
Doli nga shtypi më 10.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 32 lekë